

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-138/12

Prishtinë, 17 janar 2014

Në çështjen juridike të:

**Komuna e S., përfaqësuar nga Avokati Publik Komunal,
Suharekë**

Pala ankuese

kundër

J.A.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, anëtar të kolegjit, duke vendosur me ankesën e paraqitur ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/100/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA49488), të datës 23 shkurt 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 17 janar 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/100/2011, i datës 23 shkurt 2011, për aq sa ka të bëjë me lëndën e regjistruar me numrin KPA49488.
2. Hedhet kërkesa e J. A. përkitazi kërkesës së regjistruar me numrin KPA49488 për shkak të mungesës së juridiksionit.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 23 nëntor 2011, J. A. ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkonte që të njihej si pronar i ngastrës kadastrale nr.1765 në vendin e quajtur “Kodra”, arë, e klasës 5, në sipërfaqe prej 0.30.07 ha, të Zonës Kadastrale Mohlan, Komuna e S.. Posedimi për këtë pronë të paluajtshme është humbur me dt. 13.qershor 1999, si rezultat i rrethanave në Kosovë në vitin 1998/1999. Kërkon të drejtën e konfirmimit të pronësisë dhe ri -posedimin. Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesë ka paraqitur në AKP këto prova shkresore edhe atë:

- Fletën poseduese nr.58 të Drejtorisë Gjeodete Komunale në S. i dt. 11.12.1985. Me këtë fletë poseduese konstatohet se titullar i së drejtës së pronësisë të ngastrës kadastrale që është objekt i kërkesës është A. J., paraqitësi i kërkesës.
- Letërnjoftimin të paraqitësit të kërkesës të lëshuar nga Komuna e S. nr.13640 të dt.17.03.1981.

2. Në ndër kohë vajza e paraqitësit të kërkesës Ž. M. ka paraqitur në Sekretarinë Ekzekutive të AKP-së edhe këto dëshmi :

- Letërnjoftimin e vajzës së paraqitësit të kërkesës Ž. M. të lëshuar nga Komuna e S. e dt. 27 qershor 2006 (organi paralel i Serbisë) .
- Certifikatën e vdekjes së paraqitësit të kërkesës J. A. i dt.19 tetor 2009 të lëshuar nga Komuna e Uzhicës , Republika e Serbisë, me të cilën konstatohet se paraqitësi i kërkesës ka vdekur me 11 tetor 2009 në Uzhicë, R.Serbisë.

3. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka siguruar sipas detyrës zyrtare certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.UL-72116028-00058 të lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në S. i dt.5 maj 2008, me ç ‘rast ka konstatuar se ngastra kadastrale 1765 evidentohet në emër të paraqitësit të kërkesës. Po kështu, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka konstatuar se fleta poseduese me nr.58 i dt.11.12.1985 lidhur me ngastrën kadastrale 1765 të Zonës kadastrale Mohlan të Komunës së S. është identike me certifikatën mbi të drejtat e paluajtshme nr.UL-72116028-00058 të lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në S. i dt.5 maj 2008.

4. Në prill të vitit 2008 AKP ka bërë njoftimin në lidhje me kërkesën duke e vendosur një shenjë në vendin ku supozohej se ndodhej ngastra.

5. Në muajin qershor të vitit 2010, AKP përsëri ka bere njoftimin në lidhje me kërkesën, këtë herë duke e shpallur kërkesën në Gazetën Njoftuese nr. 5 dhe në Buletinin e Zyrës së Pronës të UNHCR-it. Gazeta dhe Lista i ishin lënë një pronari të një shitoreje në fshatin Mohlan i cili kishte pranuar t’i vejë ato në dispozicion të palëve të interesuara. Publikimet e njëjta gjithashtu ishin lënë në hyrje dhe dalje të fshatit Mohlan, si dhe në disa zyra publike në S.. Shpërndarja dhe publikimi i Gazetës është bërë edhe në ndërtesën e Komunës, Gjykatën Komunale si dhe në Zyrën Kadastrale Prizren.

6. Pasi që askush nuk ishte përgjegjës asnjë palë kërkesa ishte trajtuar si e pa-kontestuar dhe KKPK me vendimin e vet KPCC/D/A/100/2011 të datës 23 shkurt 2011, kishte miratuar kërkesën, dhe duke vendosur se paraqitësi i kërkesës kishte dëshmuar të drejtën pronësore me ç ‘rast ia ka pranuar të drejtën pronësore e ngastrën së kërkuar si dhe duke ia kthyer në ri posedim.

7. Me datën 14 nëntor 2012 Avokati Publik i Komunës së S. ka paraqitur ankesë (nga tani e tutje: pala ankuese) në AKP, ku theksonte se ngastra 1765 që është regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës por shfrytëzohet për nevojat e Shtëpisë së Shëndetit në f. Moholan, Komuna e S.. Më tej thekson se sipas vendimit 6672/54 i dt. 02 korrik 1955 ajo ngastër është eksproprijuar sipas kadastrit përshkruar për interes të ndërtimit të shkollës, dhe se para 20 vjet në të njëjtën ngastër është ndërtuar objekti i shtëpisë së shëndetit. Këto ndryshime sipas vendimit të cekur nuk janë evidentuar në kadastrë, ndaj edhe më tej ajo pronë e paluajtshme është në emër të paraqitësit të kërkesës.

8. Me dt. 27 dhjetor 2012 ankesa i është dorëzuar vajzës së paraqitëses të kërkesës (nga tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) dhe se e njëjta ka paraqitur me 21 janar 2013 përgjigje në ankesë. Në përgjigje në ankesë ajo thekson se, paraqitësi i ankesës nuk ka marr pjesë në procedurën administrative të AKP-ës nga njoftimi me publikim të kërkesës në gazetën zyrtare apo në organet

përkatëse publike si dhe dokumentacioni i eksproprijimit të dorëzuar nga pala ankuese nuk i referohet pronës së paluajtshme të babait të sajë S. A. por gjyshit të sajë J. A., prandaj propozon që ankesa të hedhet apo refuzohet si e pabazuar.

Arsyetimi ligjor:

9. Sipas Nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të amandamentuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave të cilat lidhen me pronën e paluajtshme, duke përfshirë këtu pronën bujqësore dhe atë komerciale, pala mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh pas njoftimit mbi vendimit.

10. Komuna e S. nuk është palë para KKPK-ës. Prandaj, Gjkata Supreme duhet të vendosë nëse ankesa është pranueshme.

11. Gjkata Supreme në disa aktgjykime ka marrë qëndrim që ankuesi i cili nuk ishte në dijeni për procedurën para KPKK-ës, mundet të ankimoj vendimin e KPKK-ës kur njoftimi i kërkesës është bërë përmes publikimit në Gzetën Njoftuese të AKP-ës dhe në Buletinin e UNHCR, dhe jo me vendosjen e njoftimit në pronën e kërkuar. Gjkata Supreme i referohet lëndës GSK-KPA-A-109/12, në të cilën thekson se:

“Ankesa është e pranueshme edhe pse ankuesi nuk ishte pjesë e procedurës para KKPK-ës. Kjo rrethanë nuk mund të shkoj në dëm të ankuesit meqë ai nuk ishte njoftuar në mënyrë të rregullt për kërkesën. Njoftimi i kërkesës sdhte bërë përmes publikimit në Gazetën Njoftuese të AKP-ës dhe Buletinin e UNHCR. Sidoqoftë, kjo paraqet “përprjekje të mjaftueshme” për njoftimin e kërkesës ashtu siq është kërkuar me nenin 10.1 të rregullorës vetëm përjashtimisht. Ky lloj përjashtimin nuk gjen vend në këtë lëndë. Meqenëse Gjkata nuk mund të përjashtoj faktin se ankuesi nuk ka qenë në dijeni për kërkesën, ai duhet të pranohet si palë në procedurë – ankesat e tija janë të pranueshme”

12. Në lëndën GSK-KPA-A-62/12 Gjkata Supreme ka theksuar që nga institucionet publike pritet që ato do të duhej të ishin në dijeni për publikimet e AKP-ës, prandaj, institucionet publike nuk mund të arsyetohen se nuk ishin në dijeni për kërkesat të cilat ishin publikuar në këtë mënyrë.

13. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur si rregull që është më strikte për institucionet publike sesa për personat privatë dhe subjektet.

14. Gjykata Supreme gjen se parimi bazë i aplikuar në lëndën GSK-KPA-A-62/12 nuk mund të akceptohet në këtë lëndë në të cilën KPKK-ja ka vendosja në lënda është jashtë jurisdiksionit të saj. Pasojat e kësaj praktike do të ishin që intersat e rëndësishme publike do të mund të cenoheshin nga vendimet e paligjshme. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata Supreme gjen si të paarsyeshëm lëshimin e komunës për të qenë e informuar për kërkesën, dhe vendos që ankesa është e pranueshme.

15. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën ,por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat ndaj asaj prone për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.

16. Me ekspertizën kadastrale të ekspertit të gjeodezisë i dt.03 shtator 2013, konstatohet se sipas shikimit të ortofotos dhe kopjes së planit në ngastrën kadastrale që është objekt i kërkesës është ndërtuar shkolla fillore dhe anbulanca e fshatit Molhan.

17. Po kështu, sipas urdhrit të kësaj gjykate i dt.31 tetor 2013,Drejtoria për Shërbime pronësore-Juridike dhe Kadastër të Komunës së Suharekës me përgjigjen nr.245 i dt.14 nëntor 2013, në konfirmon se në një pjesë të ngastrës 1765 ishte e ndërtuar shkolla në f. Molhan e tipit montazh në vitin 1973 e cila për shkak të shkatërrimit nuk ekziston. Rruga që kalon nëpër këtë ngastër ekziston që nga paralufta.

18. Nga këto dëshmi me pa mëdyshje mund të konfirmohet fakti se KKPK rrjedhimisht Kolegji i ankesave i Gjykatës Supreme nuk ka juridiksion për të vendosur për këtë çështje konkrete juridike. Kjo nga se, nga faktet e vërtetuara dhe provat e administruara nuk rezulton se paraqitësi i kërkesës dhe rrjedhimisht bartësi i të drejtës pronësore, është zhvendosur nga pronat e kërkuara dhe se e kanë humbur posedimin përkatësisht shfrytëzimin e këtyre pronave si pasojë e konfliktit apo për shkak të rrethanave që kanë lindur drejtpërdrejtë dhe rezultojnë nga ai konflikt që ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka siguruar ndonjë provë për të provuar faktet relevante se humbja e posedimin apo pamundësia e ushtrimit mbi pronën lidhet ose rezulton nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/1999. Pala

përgjegjëse ka pasur për detyrim t'i provojë ato fakte vendimtare të cilat i pretendon e që ndërliken me humbjen e posedimit për shkak të këtij konflikti.

19. Nga kjo rezulton se humbja ose pamundësia e ushtrimit të drejtës së posedimit i referohet kohës para shpërthimit të konfliktit të armatosur në Kosovë 1998/99 – pra para se konflikti i armatosur kishte filluar.

20. Prandaj, vendimi i KKKPK-së është dashur të anulohet dhe kërkesa të hedhet poshtë (neni 11.4 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Udhëzim juridik

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, i amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Dag Brathole, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it